



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201502564/4

Tiranë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2015

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201502564/3

Tiranë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2015

**Lënda:** Rekomandohet *"Fillimi i hetimit për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare" ndaj shtetasit L. S., me detyrë shëf i Seksionit për Krimet në Komisaratin e Policisë nr.5 Tiranë, e kryer në bashkëpunim me persona të tjerë, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal".*

**Drejtuar :** Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor  
Z.Petrit FUSHA

**TIRANË**

**Për dijeni:** Prokurorit të Përgjithshëm  
Z. Adriatik LLALLA

**TIRANË**

I nderuar Z. FUSHA,

Avokati i Popullit më datën 10.12.2015, ka filluar me iniciativë rastin e bërë publik në media për dhunën e ushtruar nga punonjësit e policisë së Komisarariatit nr.5 Tiranë, ndaj shtetasit A. H., pjesëmarrës në protestën e organizuar më datë 8 Dhjetor 2015, në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit".

Mbi këtë shqetësim është urdhëruar kryerja e një hetim të pavarur administrativ nga një grup ekspertësh të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Në vijim të hetimit administrativ janë kryer një sërë veprimesh të cilat kanë konsistuar në marrjen e shpjegimeve të shtetasit të dëmtuar A. H., dhe personave të tjerë pjesëmarrës në protestë dhe të arrestuar nga Policia e Shtetit si, A. K., A. F., Xh. Ç., dhe S. D.; punonjësve të policisë të Komisarariatit

të Policisë nr.5, të cilët kanë marrë pjesë në kontrollin e banesës të shtetasit A. H., si dhe punonjësve të policisë të Komisarariatit nr.1 që kanë kryer veprime hetimore procedurale me personat e arrestuar; janë administruar fotokopje të fletëve të regjistrimit për evidentimin e personave të arrestuar/ndaluar, fotografi të shtetasit A. H., përpiluar kërkesa për kryerjen e ekspertimit mjeko ligjor drejtuar Institutit të Mjekësisë Ligjore datë 10.12.2015, si dhe administruar akti i ekspertimit mjeko ligjor nr.1304, datë 15.12.2015.

Nga hetimi administrativ i kryer rezultoi se:

### **Rrethanat e ngjarjes**

Shtetasi A. H., banon në Kamëz të Tiranës dhe më datë 08.12.2015, bashkë me djalin E. H., dhe shokun e tij B. R., nga Lapraka kanë shkuar dhe marrë pjesë në protestën e organizuar nga Partia Demokratike në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Ata janë larguar nga protesta aty rreth orës 14.00, duke shkuar në shtëpiat e tyre.

Në ditën e ngjarjes datë 8 Dhjetor 2015, rreth orës 22.00 në banesën e shtetasit A. H., kanë shkuar punonjësit e policisë së Komisarariatit nr.5, të cilët kanë hyrë nga muret rrethuese të banesës dhe mandej kanë kontaktuar me të, duke kryer kontrollin e banesës. Pas kësaj e kanë shoqëruar në mjediset e Komisarariatit të Policisë ku në zyrën e shefit të Seksionit të Krimeve nga ai dhe tre punonjës të tjerë civilë është ushtruar dhunë fizike.

### **Veprimet e kryera**

#### **Baza për fillimin e procedimit penal**

Në shpjegimet e tij të datës 10.12.2015. shtetasi A. H., ka sqaruar ndërmjet të tjerave se: *"...Shkova bashkë me punonjësit e policisë në Komisariatin e Policisë Kamëz. Ata më thanë se të kërkon shefi i krimeve në zyrë. Këtu, shefi i krimeve më pyeti se si ishte puna, dhe unë i tregova për pjesëmarrjen korrekte në protestë. Ai më tha mos ma ngri zërin se do të të q.. r...t, fjalë fyese të cilën e përdori shumë herë. Pastaj shefi i krimeve bashkë me tre civilët e tjerë filluan të më qëllonin me grushte e shqelma në fytyrë, në kokë, në bark dhe nga të dy këmbët. Goditjet vazhduan për rreth gjysëm ore, ndonëse une e kisha të pamundur të mbrohesha. Pastaj më çuan në dhomën e sigurisë me dryn, ku më mbajtën 1 orë dhe prej këndeje më transferuan në Komisariatin e Policisë nr.1 Tiranë. Dua të them se në Komisariatin nr.1 dhe Drejtorinë e Policisë jam trajtuar me korrektesë".*

Shtetasi B. R., pjesëmarrës në protestë bashkë me të dëmtuarin A. H., në deklaratimet e tij të datës 15.12.2015, shpjegon se: *"Dua të them se A., e kam takuar një ditë pasi u lirua nga dhomat e sigurisë, në Laprakë. E pashë që ishte i dhunuar kryesisht në fytyrë dhe sidomos në veshin e majtë dhe pas tij në kokë, të cilën e kishte të nxirrë. E kam pyetur se çfarë të ka ndodhur dhe më tha se më rrahën në Komisariatin e Kamzës në zyrën e shefit të krimeve, ai me tre punonjës civilë".*

Shtetasi E. H., i cili është djali i të dëmtuarit A. H., në deklaratimet e datës 15.12.2015, shpjegon se: *"Me sa më kujtohet babai im ka dalë nga Policia më*

*datë 10 Dhjetor 2015, rreth orës 18.00 dhe kur doli nga Drejtoria e Policisë unë e takova dhe e pashë se ishte i dëmtuar kryesisht në fytyrë, nga të dy veshët dhe më shumë veshi i majtë. Babai më tha se e qëlluan me grushte e shqelma, shefi i krimeve me disa persona civilë në zyrën e tij, në Komisariatën e Policisë nr.5 Tiranë”.*

Në deklarime e tyre dhënë para Ndhmëskomisionerëve të Avokatit të Popullit më datë 14.12.2015, shtetasit L. S., me detyrë shefi i Seksionit të Krimeve si dhe N. Sh., G. K., dhe A. Y., agjentë të policisë gjyqësore, kanë shpejguar se kanë kryer veprimet hetimore procedurale për shtetasin A. H., por ndaj tij nuk është ushtruar dhunë fizike.

Në regjistrin e vizitave mjekësore që administron Komisariati i Policisë Nr.1 Tiranë dhe konkretisht në numerin rendor 490, në emrin e të ndaluarit A. H., i datëlindjes 15.04.2015, datë e vizitës 09.12.2015, tek rubrika konstatime është shkruar: *“Nuk ka ankesa shëndetësore, pajiset me kartelë, por vërehet hematomë (abrasion shëndeti, në pjesën e fytyrës, sinistra”.*

Në proces verbalin e konstatimit mbajtur datë 08.12.2015, mbajtur nga punonjësit e dhomave të sigurisë në Komisariatën e Policisë nr.1 Tiranë, për të arrestuarin A. Z. H., është shkruar: *“Nuk ka shënja të dukshme trupore dhe as pretendim e për dhunë fizike në Kom.Pol.Nr.1. Vërehen dëmtime në fytyrë në anën e majtë, contusion capitis et hemtomë ..sinistra”.*

Në aktin e ekspertimit mjeko ligjor nr.1304, tek pjesa **Ekzaminimi Objektiv** ndërmjet të tjerave thuhet: *“ Lokalisht vërehen, një ekimozë në regjionin ballor të majtë, e cila zbret drejt mollëzës së faqes së majtë, me ngjyrë lejla, me trajtë të çrregullt, me përmasa 8X6 cm. Llapa e veshit të majtë është lehtësisht e enjtur, me ngjyrë lejla, si në pjesën e përparme ashtu dhe në pjesën e pasme të saj. Në mollëzën e faqes së djathtë vihen re dy ekimoza me ngjyrë lejla me përmasa 2X2.5 cm dhe 2X1.5 cm. Në pulpën e kërcirit të djathtë vihet re një ekimozë me trajtë vezake me përmasa 9X7 cm.*

*Për faktin se shtetasi A. H., ankonte dhe për ulje të dëgjimit, u bë një konsultë me mjekun otojatër, nga e cila rezulton:-ORL numer 10899. Pacienti ankoi për dhimbje të forta të veshit të majtë, zhurmë dhe ulje të dëgjimit .Me otoskop vihet re membrama timpanike e veshit të majtë është e përforuar. Në kanalën e jashtëm të dëgjimit shihen kuagula gjaku. Në audiometri ulje mixte e kurbës kockore dhe ajrore 6 decibell. Dëmtim i membramës dhe nervit dëgjimor.*

Ndërsa tek **Konkluzionet e aktit mjeko ligjor** thuhet :

*1.Në trupin e shtetasit A. H., u konstatua dëmtim i membramës timpanike të veshit të majtë, dëmtim i nervit të dëgjimit e shoqëruar kjo me ulje të dëgjimit nga ky vesh në masën 60 decibell. Po ashtu u konstatuan ekimoza me lokalizimet e përshkruara më sipër.*

*2. Këto dëmtime janë shkaktuar me mjet të fortë mbretës.*

*3.Dëmtimet e mësipërme janë shkaktuar jo më parë se pesë ditë nga dita e vizitës mjekësore.*

*4. Dëmtimet e mësipërme nuk kanë qënë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit dhe si të tilla futen në kategorinë e dëmtimeve që shkaktojnë humbje të aftësisë për punë në masën mbi nëntë ditë. Për të parë se sa është përqindja*

*e humbjes së përhershme të dëgjimit të veshit të majtë, mendojmë se duhet ekzaminuar pas tre muajsh nga dita e ekzaminimit nga ana e jonë”.*

Më datë 10.12.2015 nga Ndhmëskomisionerët e Avokatit të Popullit, pas marrjes së deklarimeve të shtetasit A. H., në mjediset e dhomave të sigurisë në Drejtorinë e policisë Tiranë është bërë fotografi e pamjes së tij të jashtme, ku dallohen dëmtimet në pjesën e fytyrës (fotografite nr.1 dhe 2). Është administruar dhe një fotografi e shtetasit Arben Hajdari gjatë protestës tek e cila nuk shihen dëmtime në pjesën e jashtme të fytyrës (fotografia nr.3). Po ashtu është administruar dhe artikulli i gazetës “Shekulli” datë 10.12.2015, A. H.,: *“Më dhunoi shefi i krimeve”* (pas intervistës së dhënë prej tij në dritaren e dhomave të sigurisë të Komisariatit të Policisë nr.1 Tiranë).

### **Mendime dhe përfundime**

Duke analizuar në tërësi ngjarjen me provat e administruara rezultoi se:

Parë në tërësi veprimet e kryera nga punonjësit e policisë të Komisariatit nr.5 Tiranë, janë të parregullta dhe bien ndesh me dispozitat përkatëse ligjore dhe akteve nënligjore të cilat normojnë veprimtarinë e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe konkretisht:

Nenin 105 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku thuhet: *“Etika e Policisë së Shtetit përmban parimet dhe normat që rregullojnë raportet e sjelljes, qëndrimin, plotësimin të detyrave dhe komunikimit të punonjësit të Policisë për të vepruar në përputhje me ligjin, me standartet më të larta profesionale në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe në respektim të dinjitetit njerëzor të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.*

Nenin 133 pika 1 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” ku thuhet: *“Punonjësi i Policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura”.*

Me këto veprime punonjësit e policisë janë përgjegjës sipas nenit 211 të “Rregullores së Policisë së Shtetit”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.750 datë 16.09.2015, ku thuhet: *“Punonjësi është përgjegjës për përdorim të paligjshëm dhe të paarsyeshëm të forcës, nëse: 1.Përdor forcën në intesitet dhe kohë, mbi masën që është e domosdoshme për të arritur objektivin legjitim dhe të ligjshëm të Policisë”.*

Përdorimi i fjalëve fyese nga punonjësit e policisë përbën shkelje të sjelljes dhe etikës në kryerjen e detyrës, e cila bie ndesh me nenin 94 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, ku thuhet: *“Punonjësi i Policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave”.*

Këto veprime bien ndesh me Misionin e Policisë së Shtetit, që është ruajtja e rendit dhe sigurisë publike në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, parashikuar në nenin 2 të ligjit nr.108/201, “Për Policinë e Shtetit”.

Shteti i ka dhënë Policisë përgjegjësi për kryerjen e shërbimeve të policimit në respekt të shtetit ligjor. Prandaj dhe shërbimet policore duhet t’i përshtaten parimeve të demokracisë, llogari dhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Por, kulmi i veprimeve abuzive dhe arbitrare është ushtrimi i dhunës fizike nga shefi i krimeve të Komisarariatit të Policisë nr.5 L. S., në bashkëpunim me persona të tjerë, kolegë të tij, të cilët ka qëlluar me grushte në pjesë të ndryshme të trupit shtetasin A. H., në zyrat e Policisë. Kryerja e këtyre veprimeve arbitrare në mjediset e Policisë gjatë ushtrimit të detyrës i kapërshen kompetencat dhe si e tillë është e kundërligjshme me pasoja në shëndetin e qytetarëve dhe cënimin e dinjitetit njerëzor.

Nga kryerja e veprimeve të ndryshme gjatë hetimit administrativ, si deklaratimet e personit të dëmtuar apo e personave që kanë dijeni për ngjarjen, administrimi i dokumenteve të ndryshme shkresore si, akti i ekspertimit mjeko ligjor me konkluzionet e tij, fotografitë e personit të dëmtuar A. H., dhe proces verbaleve të konstatimit mbajtur nga punonjësit e policisë së Komisarariatit të Policisë Nr.1 Tiranë, krijohet një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova se shefi i Seksionit të Krimeve në K.P.Nr.5 Tiranë L. S., në bashkëpunim me persona të tjerë kolegë të tij, kanë kryer veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, në dëm të shtetasit A. H., parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal.

Objekti i veprës penale të mësipërme është marrëdhënia juridike e vendosur për të rregulluar veprimtarinë e rregullt shtetërore ose shërbimin publik që kanë të bëjë me respektimin e lirive të shtetasve, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Për zhvillimin e një hetimi të gjithanshëm dhe objektiv, do të sugjeronimin që organi procedues duhet të kryejë dhe veprime të tjera hetimore të cilat konsistojnë në:

- a. Identifikimin e punonjësve të policisë kriminale të cilët kanë qënë në zyrën e shefit të Seksionit të Krimeve, në Komisariatin e Policisë nr.5 Tiranë, dhe kanë ushtruar dhunë fizike ndaj shtetasit A. H., e më pas sqarimin e pozitës së tyre procedurale në procedimin penal.
- b. Marjen dhe administrimin si provë materiale të kasetave filmike që ndodhen në hyrje të ndërtesës së Komisarariatit të Policisë nr.5 Tiranë, apo dhe mjediset e brëndshme si në koridore, apo zyra, për të për të sqaruar dhe konfirmuar gjendjen fizike dhe shëndetësore, pamjen e jashtëme të shtetasit A. H., gjatë hyrjes dhe daljes nga mjediset e Komisarariatit të Policisë.
- c. Marrjen e deklaratimeve të personelit mjekësor të cilët kanë parë dhe ekzaminuar të arrestuarin A.H., në dhomat e sigurisë në Komisariatin e Policisë Nr.1 dhe Drejtorinë e Policisë Tiranë.
- ç. Duke mbajtur parasysh dhe vlerësuar deklarinimin e të dëmtuarit A. H., se gjatë ushtrimit të dhunës nga shefi i krimeve me kolegët e tij, ka qënë i pranishëm dhe shefi i Komisarariatit të Policisë nr. 5, hetimi duhet të zgjerohet dhe në drejtim të veprës penale “Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”, parashikuar nga neni 251 i Kodit Penal.

Referuar nenit 76 të Kodit të Procedurës Penale, i cili bën fjalë për “Kompetencën tokësore”, në interes të çështjes dhe kryerjes së një hetimi objektiv e të paanshëm, do të sugjeronim për këtë qëllim që shqyrtimi dhe

vlerësimi i Rekomandimit të bëhej nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor më të afërt me Tiranën, e cila do të çmohej nga Ju.

Për sa sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “ç” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, i rekomandon Prokurorisë të fillojë hetimet në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”*.

## **REKOMANDOHET**

“Fillimi i hetimit, për veprën penale *“Kryerja e veprimeve arbitrare”*, ndaj shtetasit L. S., me detyrë shëf i Seksionit të Krimeve në Komisaratin Policisë Nr.5 Tiranë, e kryer në bashkëpunim me persona të tjerë, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bashkëlidhur ju dërgojmë fotokopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Proces verbal për marrjen e shpjegimeve të ankuesit A. H., datë 10.12.2015.
2. Proces verbal i marrjes së shpjegimeve të personit që ka dijeni për rastin në shqyrtim, të shtetasve E. H., dhe B. R., datë 15.12.2015.
3. Proces verbal i marrjes së shpjegimeve të personave që kanë dijeni për rastin në shqyrtim, L. S., N. S., G. K., dhe A. Y.,.
3. Kërkesa për kryerjen e ekspertimit mjeko ligjor datë 10.12.2015.
4. Akti i ekspertimit mjeko ligjor nr.1304 i I.M.L Tiranë.
5. Fletë nga rregjistri i personave të arrestuar në Komisaratin e Policisë nr.2 Tiranë datë 29 Qershor 2015.
6. Fletë nga rregjistri i proces verbaleve të konstatimit të K.P.Nr.1 Tiranë, viti 2015.
7. Fletë nga rregjistri i vizitave në K.P.Nr.1 Tiranë, viti 2015
8. Fotografi të personit të dëmtuari A. H., 3 –tre copë-
9. Artikulli i gazetës “Shekulli” datë 10.12.2015.

*Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**

